

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 206/3 prot.

Urë Vajgurore, më 25.01.2024

VENDIM

Nr. 07 Datë 25.01.2024

“Për subvencionimin e qirasë së familjeve të varfëra dhe listën e familjeve përfituese”.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 25.01.2024, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Investimeve, Kontrollit të Projekteve dhe Strehimit dhe në mbështetje të Nenit 8 pika 2, Neni 9 pika 1, Neni 24 pika 2, Neni 55 pika 2, 6 dhe Neni 54 të ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Neni 41, Neni 42, Neni 43 të ligjit Nr.22/2018 “Për strehimin social”, të thirrjes nga Ministria e Brendëshme “Mbi programet e strehimit që do të subvencionohen nga buxheti i shtetit për vitin 2024”, të VKB Nr 52 datë 26.12.2023 Për miratimin e programit Buxhetor afatmesëm 2024 – 2026 dhe detajimin e buxhetit për Vitin 2024 referuar termave të referencës për projektet e investimit që do të financohen nga buxheti i shtetit në vitet 2022-2023 dhe Tabelës Nr.5 “Të ardhurat vjetore për frymës sipas bashkive, për vitin 2022”, për Bashkinë Dimal.

VENDOSI :

Me 13 vota PRO, nga 13 Këshilltarë prezentë:

1. Të miratojë vlerën 30% për bashkëfinancimin e projektit në programin e strehimit për subvencionimin e qirasë së familjeve të varfëra dhe listën e familjeve përfituese.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit Bashkiak të publikojë vendimin në faqen zyrtare të Këshillit Bashkiak Dimal.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

AVDULLA SALILLARI



Për vitin 2024 do të aplikohen familjet sipas listës së poshtë shënuar.

Nr	Permbledhese e familjeve	Venbanimi
1	Hajrie Caushi	Ure Vajgurore
2	Gazmira Bani	Ure Vajgurore
3	Liri Cepele	Ure Vajgurore
4	Miri Mbrakulli	Pashalli
5	Partizan Mbrakulli	Poshnje
6	Nertil Kamenica	Hinge
7	Ylli Calameni	Kutalli
8	Klorentina Veshi	Ure Vajgurore
9	Zarif Hajderaj	Ure Vajgurore